

GRUPET E KOLEGËVE

Një qasje novatore ndaj edukimit në vazhdim në Kujdesin Shëndetësor Parësor

Projekti “Shëndet për të Gjithë” (HAP) vuri në zbatim për herë të parë modelin e Grupeve të Kolegëve në vitin 2015 dhe që prej asaj kohe ka mbështetur fuqizimin e tyre si një qasje novatore dhe efektive për edukimin në vazhdim në Kujdesin Shëndetësor Parësor (KSHP) në Shqipëri. Gjatë thujtse një dekade, Grupet e Kolegëve kanë evoluuar nga një nismë pilot e mbështetur nga HAP në një mekanizëm të institucionalizuar për zhvillim profesional dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë në KSHP. Ato kanë kontribuar në përkthimin e protokolleve klinike kombëtare në praktikën e përditshme, në përmirësimin e punës në ekip dhe në standardizimin e kujdesit në të gjithë sistemin e kujdesit shëndetësor parësor.

Konteksti dhe nevoja për Grupet e Kolegëve

1. Mundësi të kufizuara për edukim në vazhdim dhe për programe të përshtatura me nevojat e ofruesve të KSHP-së (mjekëve dhe infermierëve të familjes), gjë që i detyron ata të marrin pjesë në aktivitete edukative të hartuara për specialitete të tjera.
2. Mungesa e një përfaqësimi të fortë dhe aktiv të mjekëve dhe infermierëve të familjes në organizatat profesionale, çka kufizon ndikimin që mund të kenë për hartimin dhe ofrimin e programeve të edukimit në vazhdim të përshtatura me nevojat e profesionit të tyre.
3. Nevoja e vazhdueshme për t’i pajisur profesionistët shëndetësorë me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për t’iu përgjigjur problemeve në rritje të shëndetit në komunitet si pasojë e ndryshimeve demografike.

Çfarë janë Grupet e Kolegëve?

Grupet e Kolegëve (GK) janë një formë e strukturuar e edukimit në vazhdim, përmes së cilës mjekët, infermierët, psikologët, punonjësit socialë dhe profesionistë të tjerë të shëndetësisë mbledhen për të shkëmbyer përvoja, për të analizuar raste dhe për të reflektuar mbi praktikën e tyre. Përmes diskutimit të udhëzuesve dhe protokolleve të bazuara në evidencë dhe sfidave reale klinike dhe organizative, GK-të i ndihmojnë pjesëmarrësit që të identifikojnë boshllëqet në praktikë, të reduktojnë gabimet dhe të harmonizojnë kujdesin me praktikat më të mira.

Ndryshe nga trajnimet tradicionale, Grupet e Kolegëve:

- » bazohen te praktika e përditshme dhe janë të orientuara drejt zgjidhjes së problemeve;
- » nxisin ndërveprimin dhe pjesëmarrjen;
- » mbështesin mirëqenien emocionale dhe psikologjike të kolegëve;
- » zbatohen në vendin e punës;
- » përshtaten me nevojat reale për trajnim të ofruesve të KSHP-së.



Pse janë të rëndësishme Grupet e Kolegëve?

Grupet e Kolegëve ndihmojnë për:

- » zbatimin e udhëzuesve dhe protokolleve kombëtare në praktikën e përditshme;
- » përmirësimin e aftësitë klinike dhe të vetëbesimit profesional;
- » forcimin e punës në ekip dhe të bashkëpunimit ndërdisiplinor;
- » mbështetjen e ndryshimeve të sjelljes në praktikën klinike;
- » krijimin e një kulture të të nxënimit gjatë gjithë jetës, të reflektimit profesional dhe të llogaridhënies profesionale;
- » marrjen e krediteve të nevojshme për rilicensimin e mjekëve dhe infermierëve.



Si organizohen Grupet e Kolegëve?

Përbërja e grupit

8-10 profesionistë të kujdesit shëndetësor parësor (mjekë, infermierë, psikologë, punonjës socialë etj.).

Moderimi

Çdo grup drejtohet nga një facilitator i trajnuar, i cili udhëheq procesin e të nxënimit duke mbështetur përzgjedhjen e temave, planifikimin dhe moderimin e takimeve, si dhe menaxhimin e kërkesave për akreditim dhe raportim.

Takimet

Zakonisht zhvillohen çdo muaj për 1–2 orë, në cikle prej 4–6 seancash, duke përdorur metoda ndërvepruese si diskutimi i rasteve, shqyrtimi i udhëzuesve, zgjidhja e problemeve, lojërat me role dhe reflektimi mbi praktikën e përditshme klinike.

Temat

Grupi mund të përzgjedhë çdo temë që lidhet me KSHP-në në bazë të nevojave lokale dhe të prioriteteve të sistemit shëndetësor.

Akreditimi

GK-të janë të akredituara zyrtarisht si aktivitete të edukimit në vazhdim në Shqipëri, me kredite të dhëna mbi bazën e numrit total të orëve të përfunduara në çdo cikël, në përputhje me rregulloret kombëtare të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Pse ka rëndësi akreditimi

Akreditimi siguron njohje formale profesionale, mbështet kërkesat për rilicensim, rrit motivimin për pjesëmarrje dhe forcon qëndrueshmërinë afatgjatë të sistemit të të nxënimit mes kolegëve në kujdesin shëndetësor parësor.



KONTRIBUTI I HAP

- » Njohja zyrtare e Grupeve të Kolegëve si aktivitet i akredituar i edukimit në vazhdim, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 788, datë 22 shtator 2015;
- » Hartimi dhe miratimi i Udhëzuesit për Grupet e Kolegëve në bashkëpunim me Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë në Kujdesin Shëndetësor dhe Social (ASCK), botuar në vitin 2019 dhe i rishikuar në vitet 2021, 2022 dhe 2023;
- » Trajnimi i facilitatorëve mbi teknikat e moderimit, drejtimin e takimeve dhe komunikimin;
- » Mbështetja e nismave për ngritjen e Grupeve të Kolegëve;
- » Zhvillimi i materialeve trajnuese me një komponent të fortë didaktik (udhëzues dhe protokolle klinike, manuale etj.);
- » Ofrimi i materialeve trajnuese për të gjithë pjesëmarrësit;
- » Prodhimi i evidencës mbi Grupet e Kolegëve si një mjet efektiv për edukimin në vazhdim dhe forcimin e KSHP-së.

Shtrirja e zbatimit

Shtrirja kombëtare

- » 5 237 pjesëmarrës kanë qenë pjesë e Grupeve e Kolegëve (2023-2026), si mjekë, infermierë, psikologë dhe punonjës socialë;
- » 166 nga 216 qendra shëndetësore në 21 Njësi Vendore të Kujdesit Shëndetësor kanë zbatuar me sukses Grupet e Kolegëve në periudhën prill 2019 – mars 2026.

Ndikimi i Grupeve të Kolegëve në praktikën klinike

Grupet e Kolegëve kanë luajtur një rol kyç në zbatimin në KSHP të:

- » Udhëzuesve dhe protokolleve klinike për diabetin, dislipidemitë, hipertensionin, astmën dhe sëmundjen pulmonare obstruktive kronike (SPOK);
- » Udhëzuesit për menaxhimin e çrregullimeve të shëndetit mendor;
- » Manualit për kujdesin ndaj të moshuarve;
- » Procedurave të standardizuara bazë dhe të avancuara të infermierisë për shërbimet e kujdesit shëndetësor në banesë.

REZULTATET DHE NDIKIMI

Një vlerësim i kryer në Shqipëri në vitin 2025¹ tregoi se Grupet e Kolegëve kanë sjellë përfitime të rëndësishme në tri fusha kryesore.

Përmirësimi i praktikës klinike dhe i cilësisë së shërbimit

- » GK-të kanë përmirësuar përdorimin e protokolleve dhe të udhëzuesve të rinj klinikë;
- » kanë mundësuar kujdes më të standardizuar;
- » kanë përmirësuar aftësitë klinike dhe vetëbesimin profesional, duke çuar në kujdes më efektiv për pacientët;
- » kanë zgjeruar rolet profesionale, veçanërisht për infermierët, psikologët dhe punonjësit socialë.

Forcimi i bashkëpunimit ndërdisiplinor dhe i punës në ekip

- » GK-të kanë sjellë ndarje më të qartë të roleve dhe të përgjegjësisë;
- » Punë më të mirë në ekip brenda qendrave shëndetësore;
- » Rritje të mbështetjes dhe të besimit të ndërsjellë brenda ekipit;
- » Pjesëmarrje më aktive e të gjithë anëtarëve të ekipit në kujdesin ndaj pacientit.

Kontributi për zbatimin e politikave dhe strategjive kombëtare shëndetësore

- » Strategjia e Zhvillimit të Kujdesit Shëndetësor Parësor 2020–2025;
- » Programi Kombëtar për Sëmundjet Jo të Transmetueshme 2021–2030;
- » Integrimi i shëndetit mendor, i kujdesit për të moshuarit dhe i kujdesit shëndetësor në banesë në shërbimet e KSHP-së.



¹ Relacion për hartuesit e politikave "Vlerësimi i Grupeve të Kolegëve si një qasje efektive e edukimit të vazhdueshëm për ofruesit e Kujdesit Shëndetësor Parësor në Shqipëri", përgatitur nga Prof. As. Jolanda Hyska, korrik 2025